




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 686

Procesverbal nga dëgjimi publik me Organizatat

E enjte, më 20 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 15:00 – 16:00

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit - Shtime

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – Albana Fazliu si dhe Asambleistja- Zejnie Veliu.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ky takim është thirr për organizatat, pasi që tani më nëpër fshatra dëgjimet publike i kemi përfunduar. Ky takim ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, unë të them të drejtën kam prit që sot do të ketë pjesëmarrës nga organizatat më shumë, mirëpo ndoshta edhe koha është pak më jo e përshtatshme, por në bazë të afateve ligjore sot duhet që t'i përfundojmë të gjitha dëgjimet publike.

E thash që Draft Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, mirëpo kërkesat do të bëhen vetëm për vitin 2025, siç ka ndodhur edhe vitin e kaluar. Buxheti për vitin 2025 është paraparë të jetë diku afër 11 milion euro, ku ndryshe nga viti 2024 ka rritje prej afro 1 milion. Buxheti ndahet në disa kategori, në komunën e Shtimes shumica e buxhetit apo mbi 50% shkon në paga dhe mëditje, më pas e kemi kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, investimet kapitale, shpenzimet komunale dhe subvencionet. Sa i përket subvencioneve në çdo vit kemi shkuar duke i rritur ato gradualisht, në vitin 2024 kanë qenë 350 mijë ndërsa për vitin 2025 kemi planifikuar që kjo shumë të shkojë deri në 500 mijë.

Të gjitha këto kategori të cilat i përmenda e përbëjnë atë shifrën të cilën e përmenda prej afro 11 milion euro. Ju e dini që këtë vit janë rrit subvencionet në kulturë, rini dhe sport dhe kësaj më të gjitha organizatat jo qeveritare kanë pasur rritje të subvencioneve. Besojë që vitin e ardhshëm kjo rritje do të vazhdojë për të gjitha klubet dhe organizatat.

Sot do të ishte mirë që të gjitha kërkesat dhe nevojat e klubeve dhe organizatave t'i paraqisni këtu dhe ne t'i vendosim në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025.

Kërkesat :


- Behadin Rexhepi – Përfaqësues i Bjeshkatarëve “Vjosa”: Të zhvillohet turizmi në vendin tonë, pasi që kemi bukuri natyrore të shumta në numër dhe duhet të kujdesemi për to. Duhet të rregullohet shtegu për ecje deri tek Ujëvarat e Mollopolcit, pasi që ne jemi me fat që e kemi atë pjesë dhe vizitorët mahniten me bukurit e ati vendi, prandaj është e nevojshme të investohet.
Pjesë tjetër në të cilën duhet investuar është edhe “Shpella e Imer Devetakut”, pasi që nuk ka mundësi pa ndonjë intervenim të shkohet deri tek ajo pjesë.
“Shpella e Lakuriqëve”, tek pjesa e Topillës ku gjatë luftës është përdorur edhe si spital, pra ka një vlerë të madhe historike pasi që ka lënë gjurmë, mirëpo është edhe vend atraktiv.
- Besnik Brahimi – Përfaqësues i A.K.V “Ilirida”, Shpresoj që buxheti sa i përketë pjesës së kulturës viteve në vijim të ketë rritje. Ne si grup i të rinjëve jemi shumë të kënaqur.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik me Organizatat

Date: 20/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Besnik Brehim	
2	Adem Aliu	
3	Behadin Daxhapi	
4	Lulzim Sahiti	
5	Muhamet Beriqi 052 0+	
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		